



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 96/2 Prot.

Fier, më 20. 01. 2022

Lënda: Njoftim për vend të lirë pune në pozicionin Drejtor i Institucionit Arsivor

Shkolla 9-vjeçare “Xhevit Fetau” ZVAP Fier

Bazuar në Ligjin Nr.69/2012, datë 21.06.2012 “ Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në Udhëzimin nr. 2 , datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar ” i ndryshuar si edhe në VKM Nr.99, datë 27.02.2019 “ Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar” kreu 3 pika 11, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare Fier shpall procedurat e konkurimit për pozicionin e punës:

- **Drejtor i Institucionit Arsivor “Xhevit Fetau” ZVAP Fier**
- **Afati i dorëzimit të dokumentave 2 Shkurt 2022**

Kandidatët e interesuar, brenda 10 ditëve pune, të dorëzojnë pranë ZVAP Fier dokumentacionin përkatës sipas Udhëzimit nr. 2 , datë 28.01.2020 “Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar ” i ndryshuar.

1. Kushtet që duhet të plotësojë kandidati

- a) Të ketë fituar diplomë të ciklit të dytë në fushën e edukimit ose diplomë të një vlershme me të, sipas përcaktimeve të ligjit 80/2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”;
- b) Të ketë të paktën kategorinë “Mësues i kualifikuar”;
- c) Të mos ketë masa disiplinore në fuqi ndaj tij;
- d) Të ketë kryer trajnimin e detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e institucionit arsimor parauniversitar dhe të jetë certifikuar, pas hyrjes në fuqi të pikës 2 të nenit 55, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

2. Dokumentacioni i Aplikimit

- a) Jetëshkrimin dhe kopjet e njësura me origjinalin të dokumenteve që dëshmojnë pohimet në të (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 1, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- b) Kopjen e njësuar me origjinalin të librezës së punës;
- c) Kopjen e dokumentit të identitetit (ID);
- d) Tabelën me të dhënat për aplikantin (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 4, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- e) Certifikatën e drejtuesit të IPAP. Certifikimi i kandidatit për drejtor i IPAP kryhet pas zhvillimit të trajnimit të detyrueshëm përgatitor në Shkollën e Drejtorëve, për drejtimin e IPAP;
- f) Vetëdeklarimin e gjendjes gjyqësore (sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 2, bashkëlidhur këtij udhëzimi);
- g) Vërtetim nga institucioni ku punon, që nuk ka masë disiplinore në fuqi;
- h) Deklaratën e konfliktit të interesit me punonjësit arsimorë të IPAP (bashkëshort/bashkëshorte, prind, vëlla/motër, fëmijë në moshë madhore, prindër të bashkëshortit/bashkëshortes), sipas modelit të përcaktuar në shtojcën nr. 3, bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Data e shpalljes së rezultateve të verifikimit paraprak të dokumentacionit dhe afati i plotësimit të dokumentacionit pas verifikimit paraprak do të jetë sipas afateve të vendosura në pikën 10, gërma a, b dhe c, kreu C të udhëzimit nr. 2 , datë 28.01.2020”Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar.

4. Fusha e njohurive dhe aftësive mbi të cilat do të zhvillohet intervista e strukturuar:

- a) Kodi i Punës
- b) Kodi i Procedurës Administrative
- c) Ligji 69/2012”Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë “
- d) VKM nr. 99, datë 27.2.2019 “Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar”
- e) Udhëzimi nr. 12, datë 10.06.2021 "Për procedurat e pranimit e të emërimit në një vend të lirë pune në institucionet arsimore publike të arsimit parauniversitar dhe për administrimin e portalit 'Mësues për Shqipërinë'.

f) Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar

g) Rregullore për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitare në Republikën e Shqipërisë.

h) Udhëzimin nr 26 datë 25.11.2019 “Për kriteret e mësuesit ndihmës për nxënësit me aftësi të kufizuara në institucionet publike të arsimit parauniversitar”.

g) Udhëzimi nr. 2 , datë 28.01.2020”Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar.

5.Data e daljes së rezultateve të konkurimit dhe mënyra e komunikimit të tyre do të jete sipas afateve të vendosura në pikën 10, gërma g, dhe f, kreu C të udhëzimit nr. 2 , datë 28.01.2020”Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar” i ndryshuar.

Duke ju falenderuar,

DREJTORI



BRUNILDA DHAMO

